

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti për krime të rënda, kryetarja e trupit – gjyqtarja Ajser Skenderi me anëtarët e trupit – gjyqtarët: Sadije Selmani dhe Luan Berisha, me proçesmbajtësen Sheqere Braha, në çështjen penale kundër të akuzuarve Xh. B. dhe E. G. nga Mitrovica, për shkak të veprës penale kontrabandimi me migrantë në bashkëkryerje nga neni 170 par.1. lidhur me nenin 31 të KP, dhe të akuzuarit S. B. nga Mitrovica për shkak të veprës penale kontrabandimi me migrantë në ndihmë nga neni 170 par.1 lidhur me nenin 33 të KP, duke vendosur sipas aktakuzës së PSH në Prizren PP.nr.197/15 të datës 22.12.2015, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor në prezencën e Prokurorit të Shtetit Sefer Morina, të akuzuarëve dhe mbrojtësve të tyre avokat, A. R., B. S. dhe H. M. më datën 26.09.2016, mori dhe publikisht e shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

Të akuzuarit:

I.XH. B., nga i ati S. dhe e ëma Sh., e lindur A., i lindur më ... në Mitrovicë, ku edhe tani jeton, i pa martuar, me profesion mjeder, e ka të kryer shkollën e mesme ekonomike, Shqiptar – shtetas i Republikës së Kosovës, ka qenë në paraburgim prej datës 13.07.2015, dhe arrest shtëpiak deri më dt.06.01.2016.

II.E. G., nga i ati O. dhe e ëma R., e lindur P., i lindur më ... në Mitrovicë, ku edhe tani jeton, i martuar, i ati i një fëmije, punëtor, e ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së dobët ekonomike, Shqiptar – shtetas i Republikës së Kosovës, ka qenë në paraburgim prej datës 13.07.2015 dhe arrest shtëpiak deri më dt.06.01.2016.

III.S. B., nga i ati A. dhe e ëma M., e lindur S., i lindur më ... në Mitrovicë, ku edhe tani jeton, i pa martuar, me profesion autolimar, e ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së dobët ekonomike, Shqiptar – shtetas i Republikës së Kosovës.

JANË FAJTOR

I. Të akuzuarit Xh. B. dhe E. G.:

1.Se më datën 13.07.2015 rrethë orës 24,40 minuta të mesnatës në afërsi të vendkalimit kufitar të Vërmicës,Komuna e Prizrenit kontrabandojnë migrantë, me qëllim

të përfitimit të dobisë pasurore – financiare për vehte, në mënyrë të kundërligjshme, në atë mënyrë që pasi paraprakisht merren vesh mes vehti, nisen nga Mitrovica rreth orës 22:00, të datës 12.07.2015, i akuzuari Xh. me automjetin e markës “Golf 2”, me targa xx-xxx-xx, ndërsa i akuzuari E. me automjetin e markës “Mercedes” me targa xx xxx-xx, vinë në afërsi të kufirit dhe pasi iu mundësojnë shtetasve sirian si migrantë të 9 personave të hynë – kalojnë kufirin në mënyrë të paligjshme nga R. e Shqipërisë në Kosovë, i marrin në automjetet e tyre që ti transportojnë deri në Mitrovicë te vendi “V. e S.”, të cilët kishin destinacionin kalimin për në Sërbi dhe shtete të Evropës dhe se gjatë transportimit të tyre, pas kyqjes në autostradë ndalohen nga policia.

Këso dore kanë kryer veprë penale kontrabandimi me migrantë në bashkëkryerje nga neni 170 par.l. lidhur me nenin 31 të KP.

Andaj, gjykata konformë dispozitave të nenit 4, 7, 17, 18, 41, 45, 46, 73, 74, 75, 76, 83 në lidhje me nenin 170 par.l.lidhur me nenin 31 - 33 të KP i

G J Y K O N

Të akuzuarit Xh. B. dhe E. G. secilin prej tyre me dënim me gjobë në shumë prej **1000 /njëmijë/** Euro si dhe me dënim me burgim në kohëzgjatje prej **2 /dy/ viteve**, në të cilin dënim do të iu llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim – arrest shtëpiak prej datës **13.07.2015 gjerë më datën 04.02.2016.**

Obligohen të akuzuarit Xh. B. dhe E. G. që secili prej tyre në emër të paushalit gjyqësor të paguajnë shumën prej nga 350 Euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

I akuzuari S. B. konformë nenit 364 pika 1.pika 1.3. të KPP.

L I R O H E T N G A A K U Z A

Se me datë, kohë dhe vend, mënyrë dhe rrethana të njehta si në dispozitivin nën l/, të aktakuzës, i ndihmon në mënyrë të drejtëpërdrejtë dhe me qëllim të akuzuarit Xh. B. dhe E. G. duke i këshilluar, udhëzuar, siguruar dhe garantuar më parë që të kontrabandojnë me migrantë në atë mënyrë që pasi më parë kontakton dhe bisedon me të akuzuarit në Mitrovicë, për mënyrën, vendin dhe kohën se si ti transportojnë 9 persona migrantë shtetas të Sirisë, nga kufiri i Vërmicës për në Mitrovicë, iu siguron rrugën nga Mitrovica deri në kufi ashtuqë niset me automjet të tij të markës “Audi A 4”, - avant me targa xx xxx-xx, gjatë rrugës komunikon disa herë përmes telefonit me të akuzuarin Xh. dhe i tregon vendin ku duhet të ndalen e më pas saktësisht vendin ku duhet të parkohen dhe ti marrin ata, iu tregon se sa persona janë gjithsejtë dhe se duhet ti transportojnë deri

në Mitrovicë në vendin “V. e S.” dhe i siguron se askujt nuk do ti tregoi për veprimet e tyre dhe për transportimin e migrantëve do të kompenzohen përmes tij.

Këso dore kishte për të kryer veprën penale të ndihmës në kontrabandim me migrantë nga neni 170 par.1. lidhur me nenin 33 të KP.

Shpenzimet procedurale bijnë në barrë të mjeteve boxhetore të kësaj gjykate.

A r s y e t i m

Prokuroria e Shtetit në Prizren kësaj gjykate ka parashtruar aktakuzën PP.nr.197/15 të datës 22.12.2015, kundër të akuzuarve Xh. B. dhe E. G. për shkak të veprës penale kontrabandimi me migrant në bashkëkryerje nga neni 170 par.1 lidhur me nenin 31 të KP, si dhe S. B. për shkak të veprës penale kontrabandimi me migrantë në ndihmë nga neni 170 par.1 lidhur me nenin 33 të KP. Gjatë shqyrtimit gjyqësor – në fjalën përfundimtare Prokurori i Shtetit Sefer Morina ka deklaruar se qëndron në tërësi pranë aktakuzës pasi që nga të gjitha seancat e shqyrtimit gjyqësor, provave të administruara në tërësi është vërtetuar dhe provuar gjendja faktike se të akuzuarit me veprimet e tyre kanë kryer veprat penale për të cilat akuzohen. Gjendja faktike përveq provave materiale është vërtetuar edhe nga deklaratat e të dy të akuzuarve të parë të dhënë në procedurë paraprake para prokurorisë, e gjithashtu edhe nga deklaratimet e dhëna në procedurën parapenale në polici, si dhe nga procesverbali i mundësisë hetuese të veçantë ku është ndëgjuar njëri nga të dëmtuarit migrantë nga shteti i Sirisë. Ndërsa sa i përket të akuzuarit të tretë S. B. i njëjti nuk është deklaruar fare në asnjë fazë ngase është mbrojtur në heshtje, derisa me prova materiale- veçmas nga kontakti i bisedave telefonike të cilat i kanë pasur përmes numrit të telefonave në mes veti , përkatësisht me të dy të akuzuarit e parë lidhur me pregaditjen-dhënien e ndihmës në kryerjen e kësaj vepre penale padyshim se ky fakt është i vërtetuar. Andaj, ka konsideruar se është vërtetuar në tërësi teza e aktakuzës dhe është provuar fajësia për veprën penale. Ka propozuar që gjykata të akuzuarit ti shpall fajtor dhe të ia shqiptoi dënimin e paraparë me dispozitat përkatëse të Kodit penal.

Mbrojtësi i të akuzuarit Xh. B. avokat A. R. fjalën përfundimtare gjykatës ia ka parashtruar në formën e shkruar dhe se gjatë elaborimit verbal, ka deklaruar se provat e administruara nuk mbështesin dyshimin e bazuar mirë se i mbrojturi i tij ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, se në veprimet e të akuzuarit Xh. B. nuk vërtetohen elementet qenësore të veprës penale kontrabandimi me migrant në bashkëkryerje nga neni 170 par.1 lidhur me nenin 31 të KP, pasi që nuk ka të dëmtuar, nuk ka përfitim material, nuk i ka depërtuar në mënyrë të kundërligjshme –kalim ilegal dhe i njëjti nuk ka pasur për qëllim të dëmtuarit ti dërgon jashtë territorit të Republikës së Kosovës dhe se nuk ka kontrabandim si e përkufizojnë normat ligjore. Andaj edhe i ka propozuar gjykatës që të merr aktgjykim lirues. Me pohimet e mbrojtësit është pajtuar edhe i akuzuari.

Mbrojtësi i të akuzuarit E. G. avokat B. S. poashtu gjykatës ia ka dorëzuar fjalën përfundimtare në formë të shkruar, e të cilën e ka elaboruar verbalisht duke cekur se i mbrojturi i tij në të gjitha fazat e procedurës e ka mohuar që të ketë kryer veprën penale

ashtu siq pretendon prokuroria,se i mungojnë të gjitha elementet e veprës penale ashtu siq përshkruhet në aktakuzë, që i mbrojturi i tij ta ketë kryer veprën penale kontrabandim me migrant në bashkëkryerje naga neni 170 par.1 lidhur me nenin 31 të KP. Se për tu konsideruar një vepër e tillë penale që të ketë kryer i mbrojturi i tij duhet të formohen elementet esenciale të veprës penale, elemente kryesore si transportimi, përfitimi pasuror ku duhet të përshkruhet me veprim konkret, ku duhet të egzistoj përfitimi, të egzistoj lidhja kauzale ndërmejt veprimit të cilat duhet të ndërlidhen me motivin e veprës si dhe përcaktimi konkret i përfitimit.Andaj,duke i marr parasysh të lartëcekurat ka propozuar trupit gjykues që në kuptim të nenit 364 par.1 pika 3 të KP në mungesë të provave ndaj të mbrojturit të tij, trupi gjykues të merr aktgjykim lirues. Me pohimet e mbrojtësit është pajtuar edhe i akuzuari.

Mbrojtësi i të akuzuarit S. B. avokat H. M. ka theksuar se aktakuza e cila i vihet në barrë të mbrojturit të tij se kinse i ka ndihmuar dy të akuzuarit e parë në kryerjen e veprës penale kontabandimi me migrant në bashkëkryerje, kjo akuzë nuk mbështetet në prova dhe fakte. Përshkrimi faktik i veprimeve inkriminuese për S. B. janë të imagjinuara deri në shkallë hipotetike, provat dhe faktet nuk kalojnë limitet ligjore as në shkallë të indicieve e kursesi përtej dyshimit të bazuar mirë dhe në këtë kuptim edhe aktakuza e përpiluar nuk është e mbështetur në dispozitat ligjore.Në rastin konkret provat dhe të provuarit janë tejskashmërisht të zbehta, të paargumentuara.Prokuroria është thirrur në listingjet e telefonave,por asnjëherë përmbajtjen e këtyre bisedave nuk ia ka dorëzuar gjykatës apo mbrojtjes për të vërtetuar se nga cilat biseda është argumentuar cilido veprim inkriminues në kuptim të figurës së veprës penale, parakushtet e saja të përgjithshme dhe të veqanta, përshkrimi i individualitetit të veprimeve siq e kërkon neni 241 të KPP dhe bie në kundërshtim me nenin 7 të KPP mbi detyrimet e prokurorisë për vërtetimin e plotë të saktë dhe në mënyrë profesionale. Andaj, ka kërkuar nga gjykata të nxjerë aktgjykim lirues konform nenit 364 par.1 pika 3 për pamundësi të vërtetimit apo të provuarit se i akuzuari e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet. Me pohimet e mbrojtësit është pajtuar edhe i akuzuari.

Për vërtetimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike në këtë çështje gjykata gjatë procedurës së provave ka lexuar procesverbalin e mundësisë hetuese të veqantë të datës 24.07.2015 të dëmtuarit-dëshmitarit A. A., i cili në mes tjerash ka theksuar se nuk i kujtohet data e saktë, por në Kosovë ka ardhur përmes shtetit shqiptar të Shqipërisë nëpërmjet bjeshkëve. Kanë qenë 9 persona shtetas të Sirisë, se ka hyrë në mënyrë ilegale ngase nuk ka pasur me vehte dokumente personale. Poashtu ka deklaruar se kanë qenë dy persona të cilët i kanë shoqëruar –përcjellur gjatë kalimit të kufirit Shqipëri-Kosovë,të cilët i kishin lënë në një vend të caktuar-bjeshkë, dhe kishin ikur. Pastaj kanë ecur 10-15 minuta dhe kanë dalë në rrugë rurale ku janë takuar me një automjet-kombi , një person e ka ndal automjetin –kombi dhe të gjithë 9 personat kanë hyrë në atë automjet, nuk e kanë parë as rrugën dhe as nuk e kanë njohur vendin.Në momentin kur kanë zbritur në atë rrugë ka pas qarkullim të shumë automjeteve , pastaj e kanë stopuar një automjet dhe në njërin automjet kanë hyrë familja me 5 persona , ndërsa në automjetin tjetër 4 persona dhe kanë vazhduar rrugën dhe kanë hasur në kontrollin e policisë. Në automjetin në të cilën ka hyrë dëshmitari ka qenë i ngjyrës së kuqe dhe ka pas shenjën “WW”, dhe i ka ndal policia pas një udhëtimi prej 15 minutash, ndërsa për automjetin tjetër nuk i kujtohet ngase ka qenë terr dhe distancë shumë e madhe. Nuk kanë pasur destinacion të caktuar, qëllimi i tyre ishte që të shkojnë diku për të pushuar nga lodhja e udhëtimit, nuk

listingjet me datat e lartëcekura për abonentët e numrave të kërkuara si në urdhëresë-për të akuzuarit.

Nga dokumenti i qarkullimit për automjetin e markës".VW"Golf2" CRA xxx, Tipi 19 E, Dizel, me ngjyrë të gjelbërt, vërtetohet se është në emër të akuzuarit Xh. B. në të cilin automjet edhe kanë qenë personat-migrantët nga Siria në momentin kur janë ndal nga policia. Ndërsa nga dokumenti i qarkullimit për automjetin e markës"Mercedes Daimler Benz" CRA-xxx, viti i prodhimit1988, me ngjyrë të kuqe metalike vërtetohet se i takon të akuzuari E. G. B. në të cilin automjet edhe kanë qenë personat-migrantët nga Siria në momentin kur janë ndal nga policia.

Në mbrojtjen e tij i akuzuari Xh. B. në shqyrtim gjyqësor të datës 11.07.2016 ka theksuar se ditën kritike ka qenë në fshatin Dobrosht të Gjakovës , pastaj është nisur në Prizren, ku është takuar me E. G. të cilin e njihje pasiqë e kishte fqinjë dhe se rrugës në autostradë kanë hasur në disa persona të nënshtetësisë së huaj të cilët kanë stopu,janë ndal dhe i kanë marrë me automjetet e tyre veç e veç dhe janë nisur në drejtim të Prishtinës. Se nuk i kujtohen se sa persona kanë qenë po se ai me automjetin e tij i ka marrë 4 persona.Në mes tjerash ka deklaruar se ka qenë 2-3 herë në Prizren, se ditën kritike nuk ka qenë afër kufirit Vërmicë pasiqë nuk e dinë se ku është. Gjithashtu ka theksuar se nuk i ka mundësuar këtyre personave që ta kalojnë kufirin Shipëri-Kosovë, nuk i ka kërkuar të holla, komunikimi me këta persona ka qenë me gjeste pasiqë personat të cilët i kishte marrë e flisnin gjuhën arabe.I akuzuari nuk ka ngelur pranë deklaratës së dhënë në prokurori ku në mes tjerash ka deklaruar se për transportimin e migrantëve ka kontaktuar me personin me emrin R. nga Prizreni përmes telefonit, ka ardhur në Prizren dhe pikërisht me këtë person jamë takuar një javë apo dy me herët në pompen e derivateve "S. P.". Personi në fjalë i ka ofruar që të punoj si taksì, pasiqë vijnë disa persona të huaj dhe duhet ti dërgon nga Prizreni për në Mitrovicë. Këtë ofertë e ka pranuar dhe se ditën kritike është nisur nga Mitrovica së bashku me shokun e tij-këtu të akuzuarin E. G., ai me automjetin e markës"VWGolf2" ngjyrë të gjelbërt me targa xxx-xx, ndërsa E. me automjetin e tij të markës"Mercedes"ngjyrë të kuqe.Në Prizren i kanë marrë shtetasit e huaj, vazhdimisht ka kontaktuar me personin me emrin R. i cili i kishte treguar rrugën, vendin se ku gjinden këta persona sepse nuk a ka ditur saktësisht vendin ku ti takoj dhe ti marrë. Mes tjerash i kishte treguar se është një furgon kombi, dhe pasi kishte shkuar e kishte mbushur automjetin me 4 persona, ndërsa I akuzuari E. 4 apo 5 te tjerë,në dalje të autostradës nga Prizreni janë ndaluar nga policia.Është marrur vesh me R. që këta persona ti dërgoj deri në Mitrovicë për shumën e të hollave nga 100Euro për secilin automjet.

Në mbrojtjen e tij E. G. në shqyrtimin gjyqësor të datës 16.09.2016 ka theksuar se natën kritike me datën 13.07.2015 ka qenë për punët e tija në Prizren me automjetin e tipit"Mercedes",se ka pasur një defekt në automjet me ç rast e ka thirrur të akuzuarin Xh. B. në telefon dhe pas nja një orë e gjysëm kishte ardhur me automjetin e markës"Golf". Natën kritike nuk ka qenë afër kufirit por në afërsi të Prizrenit ku dhe i ka takuar disa persona të cilët kanë autostopu kështu që ai i ka marrë me automjetin e tij 5 persona, tre fëmijë dhe dy të rritur ndërsa i akuzuari Xh. i kishte marrë katër persona me automjetin tij.

I akuzuari e ka mohuar deklaratën e dhënë në prokurori,ku në prezencën e mbrojtësit të tij dhe të nënshkruar nga ana e tij ka deklaruar se me të akuzuarin Xh. është takuar me datën 12.07.2016 në Mitrovicë dhe ai i kishte treguar se duhet të shkojnë në Prizren me automjetet e tyre që ti marrin disa persona nga Siria dhe ti dërgojnë nga Prizreni në Mitrovicë, poashtu ka theksuar se ditën kritike rreth orës 22:00 janë nisur nga Mitrovica me automjetin e tij të markës”Mercedes” nërsa i akuzuari Xh. me automjetin e markës”Golf2” dhe kur kanë mbëritur në hyrje të Prizrenit kanë dalur në autostradë dhe në një vend e kanë parë një kombi ngjyrë të bardhë të ndalur në një vend parkingu në autostradë, aty është ndalur dhe në automjetin e tij i ka marrur 5 persona, ndërsa i akuzuari Xh. 4 persona dhe menjëherë janë nisur në drejtim të Mitrovicës ku pas 7-8 minutave policia i kishte ndaluar dhe pastaj bashkë me Xh. janë shoqëruar në polici.

Në bazë të provave të lartëcekura,pas vlerësimit të secilës provë një nga një dhe në lidhshmëri me njëra tjetrën gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike,se të akuzuarit Xh. B. dhe E. G. më datën 13.07.2015 rreth orës 24,40 minuta të mesnatës në afërsi të vendkalimit kufitar të Vërmicës, Komuna e Prizrenit kontrabandojnë migrantë, me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore – financiare për vehte, në mënyrë të kundërligjeshme, në atë mënyrë që pasi paraprakisht merren vesh mes vehti, nisen nga Mitrovica rreth orës 22:00, të datës 12.07.2015, i akuzuari Xh. me automjetin e markës “Golf 2”, me targa xx-xxx-xx, ndërsa i akuzuari E. me automjetin e markës “Mercedes” me targa xx xxx-xx, vinë në afërsi të kufirit dhe pasi iu mundësojnë shtetasve sirian si migrantë të 9 personave të hynë – kalojnë kufirin në mënyrë të paligjeshme nga R. e Shqipërisë në Kosovë, i marrin në automjetet e tyre që ti transportojnë deri në Mitrovicë te vendi “Varrezat e Sërbëve”, të cilët kishin destinacionin kalimin për në Sërbë dhe shtete të Evropës dhe se gjatë transportimit të tyre, pas kyqjes në autostradë ndalohen nga policia.

Gjendjen e këtyllë faktike gjykata e vërtetoi në bazë të deklaratës së të dëmtuarit-dëshmitarit A. A. të dhënë në procesverbalin e mundësisë hetuese të veçantë,i cili ka deklaruar se në teritorin e Kosovës kanë hyrë në mënyrë ilegale dhe se gjithsejt kanë qenë 9 persona dhe në momentin e arrestimit nga ana e policisë kanë qenë në automjetet e të akuzuarve dhe se në sallën e gjykimit e ka identifikuar të akuzuarin Xh. B. Poashtu ky fakt vërtetohet edhe nga deklaratat e dhëna të akuzuarve në prokurori,përkundër faktit se të njëjtit e kanë mohuar një deklaratë të tillë,mirëpo kjo deklaratë është në përputhje edhe me provat materiale-automjetet e konfiskuara nga policia dhe shtetasit sirianë të gjetur në automjetet e tyre në momentin e arrestimit.Andaj,mbrojtja e tyre gjatë shqyrtimit gjqësor për gjykatën është irelevante dhe e papranueshme pasiqë është në kundërshtim me provat e lartëcekura.

Konform nenit 170 par.1. të KP vepra penale e kontrabandimit me migrant kryhet kur kushdo merret me kontrabandim të migrantëve dhe se për këtë veprë penale është paraparë dënimi me gjobë dhe me burgim prej 2 deri në 10 vjetë. Në rastin konkret gjykata ka vërtetuar se në veprimet e të akuzuarve Xh. B. dhe E. G. formohen elementet qenësore të veprës së lartëcekur penale pasiqë të njëjtit ditën kritike me automjetet e tyre të markës “Golf 2” dhe “Mercedes” kanë kontrabanduar migrantë – shtetas Sirian, të cilët edhe i ka hasur policia në automjetin e tyre në autostradë dhe i ka arrestuar Xh. B. paraprakisht ka kontaktuar me personin e quajtur R. në Prizren, është marrë vesh për vendin, kohën dhe mënyrën e kontrabandimit të migrantëve, për çmimin e dakorduar dhe se pas kësaj e ka ftuar edhe këtu të akuzuarin E. G. e që ditën kritike kanë kontrabanduar

9 migrantë – shtetas Sirian nëpërmjet teritorit të Kosovës e të cilët migrantë kanë hyrë në territorin tonë në mënyrë ilegale, pa kurrëfarë dokumentacioni ashtu siq kanë deklaruar edhe vet në deklaratat e tyre të lartëcekura. Andaj, bazuar në të lartëcekurat, provat dhe faktet e vërtetuara gjykata edhe gjeti se që të dy të akuzuarit janë fajtor për veprën penale të kontrabandimit me migrantë nga neni 170 par.1.lidhur me nenin 31 të KP për çka edhe i shpalli fajtor dhe iu shqiptoi dënimet e parapara me gjobë dhe me burgim si në dispozitiv të aktgjykimit pasi që gjeti se janë penalo-juridikisht përgjegjës.

Sa i përket të akuzuarit të tretë – S. B. prokuroria nuk arriti që të provoi se në veprimet e tij formohen elementet qenësore të veprës penale të kontrabandimit me migrantë në ndihmë nga neni 170 par.1.lidhur me nenin 33 të KP. Kjo nga fakti se konformë nenit 33 ndihma për të kryer një vepër penale përfshin por nuk kufizohet në dhënjen e këshillave ose udhëzimeve se si të kryehet vepra penale, vënjen në dispozicion për kryerjen e veprës penale krijimin e kushteve ose menjanimin e pengesave për kryerjen e veprës penale ose premtmi paraprak se do të fsheh provat e kryerjes së veprës penale, kryesin apo identitetit e kryesit, mjetet e përdorura për kryerjen e veprës penale ose përfitimet që rrjedhin nga kryerja e veprës penale. Në rastin konkret prokuroria nuk arriti që të provoi asnjëherë prej këtyre elementeve të ndihmës. Këtu i akuzuari S. B. nuk është provuar se ka dhënë këshilla të akuzuarëve të lartëcekur dhe udhëzime se si të kryehet vepra penale pasi që i akuzuari Xh. B. ka kontaktuar me personin e quajtur R. rreth kohës, mënyrës dhe çmimit për transportimin e migrantëve Sirian e që pastaj e ka angazhuar edhe të akuzuarin tjetër E. G. Poashtu nuk është vërtetuar se këtu i akuzuari S. B. iu ka dhënë në dispozicion mjetet për kryerjen e veprës penale pasi që në vendin e ngjarjes janë hasur dhe janë konfiskuar automjetet pronar të të cilëve ishin të akuzuarit e lartëcekur. Poashtu edhe nga listingjet e lartëcekura, me datat e lartëcekura të kompanisë “Ipko” nuk mund të vërtetohet asgjë, nuk vërtetohet përmbajtja e bisedave eventuale në mes të këtu të akuzuarëve e që nga përmbajtja e tyre do të mund të vërtetohej edhe ndonjë element inkriminues sa i përket të akuzuarit S. B. pasi që prokuroria nuk ka siguruar edhe përmbajtjen – transkriptet e atyre bisedave telefonike, nga të cilat edhe eventualisht do të mund të vërtetoheshin elementet qenësore të veprës penale që i vihet në barrë të akuzuarit.

Andaj, në bazë të fakteve të lartëcekura e në mungesë të provave që do ta vërtetonin fajsinë e të akuzuarit S. B., në mungesë të elementeve qenësore të veprës penale dhe provave që do ta mbështesin të njëjtën, gjykata të akuzuarin e liroj në mungesë të provave duke marrë aktgjykim lirues si në dispozitivin nën 2/, të këtij aktgjykimi.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin për të akuzuarit Xh. B. dhe E. G. konformë nenit 73 të KP, përkitazi me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë në të njëjtën duke marrë parasysh qëllimin e dënimit, të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë në zbutjen apo rritjen e dënimit, shkallën e përgjegjësisë, motivet nga të cilat është kryer vepra, prej rrethanave lehtësuese morri parasysh qendrimin korrekt të tyre gjatë gjykimit, se janë të moshës relativisht të re, i akuzuari E. G. është i martuar dhe është i ati i një fëmiju. Ndërsa prej rrethanave rënduese motivet e kryerjes së veprës penale – për përfitim material, andaj, është mendimi i gjykatës që dënimi i shqiptuar do ta arrijnë qëllimin e vet konformë nenit 41 të KPK, se dënimi i shqiptuar është në harmoni me intenzitetin e dëmtimit të vlerës së

mbrojtur, si dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarëve dhe se do të mundësoj një balans të drejtë në mes të kërkesave që të akuzuarve ti mundësohet risocializimi dhe kërkesës së shoqërisë që ai dënim me peshën e tij të ketë karakter të përgjithshëm parandalues nga kryerja e veprave penale. Gjykata është e mendimit se dënimi i shqiptuar të akuzuarëve është në shërbim të preventivës së përgjithshme, posaqërisht të asaj të posaçme, se do të ndikoj në forcimin e moralit të shoqërisë, përgjegjësisë dhe disiplinës së qytetarëve dhe se me këtë dënim do të mund të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 41 të KP në të gjitha segmentet e tij. Dënimi i shqiptuar për kah lloji dhe lartësia është në harmoni me rrethanat e rastit, i nevojshëm dhe i mjaftueshëm për tu arritur qëllimi i dënimit konform dispozitës së lartëcekur. Dënimi i shqiptuar të akuzuarve sipas gjetjes së gjykatës është në harmoni dhe në baraspeshë me peshën e veprës së kryer penale dhe se kur të mirret parasysh shkalla e dëmtimit të vlerës së mbrojtur, mënyra dhe rrethanat e kryerjes së veprës penale, dënimi i këtillë paraqitet si i domosdoshëm me qëllim të arritjes së qëllimit të dënimit, me to shprehet gjykimi i shoqërisë për shkak të veprës së kryer penale dhe forcohet obligimi i respektimit të ligjit.

Nga të lartëcekurat u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marrë konformë nenit 450 par.2 pika 2. 6 në lidhje me nenin 453 par.1. dhe nenin 454 par.1. të KPP.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN

Departamenti për krime të rënda

Më dt.26.09.2016. P.nr.236/15

**Proçesmbajtësja
Sheqere Braha**

**Kryetarja e trupit gjykues
Ajser Skenderi**

KËSHILLË JURIDIKE: kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 dite, **Gjykatës së Apelit në Prishtinë**, nëpërmjet të kësaj gjykate.